




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office

Nr.02/39

Datë: 25.1.2024

Bazuar në nenet 13, 17 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe sipas neneve 53 dhe 57 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe sipas Vendimi të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbyesve Civil pas ankesës së zyrtarit Muhadin Halili, në pajtim edhe me nenin 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi nr. 02/761/1 i datës 01.09.2023, sipas të cilit z. Muhadin Halilit i ishte ndaluar e drejta e udhëheqjes së Drejtorisë së Prokurimit në Komunën e Shtimes në periudhë 1-vjeçare përkitazi me pezullimin e certifikatës nga KRPP-ja sipas Vendimit nr. 73/2023 të datës 24.08.2023.
2. Shfuqizimi i Vendimit nr. 02/761/01 i datës 01.09.2023 nënkupton rikthim të gjendjes së mëparshme në Drejtorinë e Prokurimit në Komunën e Shtimes sikur para marrjes së Vendimit në raport me zyrtarin Muhadin Halili, me ç'rast të njëjtit i rikthehet e drejta për nënshkrim të kontratave nga Komuna e Shtimes si autoritet kontraktues.
3. Obligohen përgjegjësit në Komunën e Shtimes për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Iu dërgohet:

Z. Muhadin Halili

Arkivit

Kryetari i Komunës
Qemajl Aliu